



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR. 1975 AKTI
DT.28.03.2019

DT.22.05.2019

VENDIM

“Ne Emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

GJYQTAR: Petrit ÇOMO

Asistuar nga sekretare gjyqesore Ina XHAFERI, me pjesemarrjen e prokurorit Ervin KARANXHA, sot, ne daten 22.05.2019, ne Tirane, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike kerkesen penale Nr.1975 Akti, qe i perket:

KERKUES: Shoqeria B... E...W..., me administrator shtetasin B.. Sh., i biri i K.dhe e B., dtl.29.08.19..., lindur ne Librazhd, banues ne tirane, Rr...., pallati ... shpk , hyrja ., kati .. , i divorcuar, me tre femije, me arsim te larte, i padenuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare,perfaqesuar ne gjykim nga av. Arben Prenga, me licence nr.4134 , me deklarim ne séance gjyqesore

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit per sekuestrimin e depozitave dt.25.02.2019, te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane

KALLZUESJA: A..Sh., e bija e D..(D.), dtl.04.08.19..., lindur dhe banuese ne Tirane, Rr. ..., mbrojtur ne gjykim nga av. Elvira Xhemali, me licence nr.9357, me prokure te pergjithshme nr.605 rep., nr.289 kol., dt. 30.05.2018, te noterit Agron T. Bajri.

BAZA LIGJORE: Neni 212 i KPPenal

Gjykata pasi mori provat, degjoi avokatin e kerkuesit, i cili ne diskutimin perfundimtar kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit, prokurorin Ervin Karanxha, i cili kerkoi pranimin e kerkeses, kerkuesi nuk u paraqit ne seancen e fundit, avokaten e kallzueses, e cila kerkoi rrezimin e kerkeses, si e shqyrtoi çeshtjen ne teresi:

VEREN

Se kerkuesi Shoqeria B... E... W..., me administrator shtetasin B.. Sh.., i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese me objekt te siperpermendur.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi se prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë mbi bazën e kallëzimit të shtetasës A..Sh., vajza e të ndjerit D.. (D..) Sh.. ka regjistruar procedimin penal nr. 4327, viti 2018, për veprat penale të parashikuar nga neni 96 dhe 248 të KPenal, procedim i cili është dërguar për gjykim në ngarkim të shtetasës E.. S...Nga hetimet ka rezultuar se në rrethana të dyshimta nga shtetasi D.. (D..) Sh.. gjatë kohës që ai trajtohej për një sëmundje të rëndë, është lëshuar prokurë dhe lidhur kontratë për transferim të drejtash në lidhje me ndryshimet në shoqërinë B... E... W... ", kontratë e cila është regjistruar pranë QKB pasi shtetasi D.. (D..) Sh. ka ndërruar jetë.Me qëllim për të hetuar në mënyrë të pavaruar në lidhje me veprën penale falsifikimi i dokumenteve është vendosur ndarja e çështjes në procedimin penal nr. 4327/1 të vitit 2018.Ne keto kushte prokuori ka çmuar duhet te sekuestrohet (bllokohet) prane Bankes " Intesa San Paolo dokumentacioni, letra me vlerë, shumat e depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjë tjetër ne lidhje me llogaritë që figurojnë në emër të shoqërisë " B...E... W...". Per keto arsye bazuar ne nenin 208, 210 te te Kodit te Procedures Penale,prokuori ne daten 25.02.2019 ka vendosur : Te sekuestrohet (bllokohet) menjehere prane Bankes "Intesa San Paolo " dokumentacioni, letra me vlerë, shumat e depozituara në llogari rrjedhëse, depozita dhe çdo gjë tjetër ne lidhje me llogaritë që figurojnë në emër të shoqërisë " B...E... W... ". Per kryerjen e ketij veprimi ngarkohet Banka " Intesa San Paolo", si dhe oficeri i policies gjyqesore Gledion Fortuzi te cilet duhet te mbajne dhe procesverbalin perkates.Per kryerjen e ketij veprimi te njoftohet menjehere Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

Gjate gjykimit avokati i qendroi kerkeses. Sipas avokatit te kerkuesit vendimi i prokurorit eshte i padrejtë, i pambështetur në ligj, ne prova e arsyetim.Mungesa e arsyetimit përbën shkelje ligjore të Prokurorisë në vendimmarrjen e saj, mbështetur në nenin 208 të KPPenale, me pasojë shfuqizimin përkatës dhe heqjen e sekuestrove mbi depozitat në emër të shoqërisë "B... E... W...".Neni 210 i KPPenale, mundëson gjykatën për ndërmarrë veprimin procedural për sekuestrim pranë bankave të depozitave bankare dhe çdo gjëje tjetër, kur ka arsye të bazuara për të menduar se kanë lidhje me veprën penale. Ky veprim mund të kryhet nga prokurori vetëm në rastet e ngutshmërisë dhe në pamundësi për të pritur vendimmarrjen gjyqësore për të realizuar sekuestron.Në rastin konkret, siç rezulton nga vendimi i prokurorit, procedimi penal ka filluar në vitin 2018. Vendimmarrja e prokurorit është realizuar muaj më vonë, çka tregon mungesën e ngutshmërisë në këtë rast, e për pasojë veprimin ekstra procedural të prokurorit nënshkrues i aktit.

Avokati paraqiti si prove shkresore raport mbi situaten e likuidimit te detyrimeve financiare te shoqerise B...E... W....

Sipas avokatit te Shoqërisë B...E... W..., kësaj shoqërie i është penguar aktiviteti normal si pasojë e sekuestros së depozitave, duke krijuar detyrime të prapambetura ndaj furnitorëve, zyrës së tatim taksave dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe punëmarrësve të shoqërisë.Sipas raportit mbi situatën e likuidimit të detyrimeve financiare (realizuar nga ekspert kontabël i miratuar Etleva Dhamo), prej muajit Mars 2019 deri më datë 17.05.2019, kjo shoqëri ka krijuar një borxh prej 1 982 666 lekë, për shkak të pamundësisë së përdorimit të llogarive të saj bankare.

Si perfundim avokati kerkoi pranimin e kerkeses, shfuqizimin e vendimit dhe heqjen e sekuestros.

Siç është përmendur edhe me lart kekruesi nuk u paraqit ne seancen e fundit me vullnetin e tij.

Edhe prokurori kerkoi pranimin e kerkeses.

Avokatja e kallezueses kerkoi rrezimin e kerkeses si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.Gjithashtu avokatja paraqiti statement bankare te Instesa San Paolo Bank, te llogarive te shoqerise B...E... W....

Sa me siper u provuan gjate gjykimit me provat shkresore te administruara ne séance gjyqesore, si dhe me shpjegimet e paleve.

Duke u bazuar ne provat e mesiperme, te marra gjate shqyrtimit gjyqesor, gjykata arrin ne perfundimin se pretendimet e kerkuesit jane te drejta dhe te bazuara ne ligj.Rezulton se prokurori e ka dhene vendimin e sekuestros, pasi kallezuesja pretendon se i jane marre aksionet ne menyre te paligjshme dhe mund ti pervetesohet pasuria e shoqerise.Ne kushtet kur rezulton se shumat e sekuestruara (sipas statment te bankes rezulton se shumat jane 31730 USD, 1993 EURO dhe 436751 leke), jane te papaerfillshme, pasi shumat e medha jane tërhequr përpara se prokurori te vendoste sekuestrimin e tyre, si dhe duke u bazuar ne faktin se shoqëria duhet te paguaje detyrimet ndaj shtetit, te treteve dhe punonjësve, gjykata çmon se llogarite e shoqerise duhet te jene aktive. Per te mos u tjetërsuar aksionet e shoqerise, si dhe pasurite e saj, prokurori mund te sekuestroje kuotat, si dhe pasurite e tjera te shoqerise, por jo llogarite e saj, te cilat duhet te jene aktive, qe shoqëria te funksionojë.Per sa me siper gjykata çmon se duhet hequr sekuestroja per llogarite bankare te shoqerise ne banken Intesa San Paolo, ndersa per pjeset e tjera është kompetence e prokurorit te vendose.

Ne keto kushte gjykata çmon se kerkesa penale Nr.1975 Akti duhet te pranohet si e bazuar ne ligj e ne prova.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te nenit 212 te KPPenale:

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses.
- Heqjen e sekuestros te llogarive rrjedhese te shoqerise B...E... W... ne banken Intesa San Paolo, sekuestruar me vendimin dt.25.02.2019, te prokurorit Ervin Karanxha.
- Ngarkohet Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, policia gjyqesore dhe Banka Intesa San Paolo per zbatimin e ketij vendimi.
- Shpenzimet gjyqesore siç jane bere.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 5 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes.
- U shpall sot, ne datën 22.05.2019 , ne Tirane!

SEKRETARE
Ina XHAFERI

GJYQTAR
Petrit ÇOMO